



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare



Viti: 2018 – Numri: 32

Tiranë – E hënë, 20 gusht 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 4956, datë 1.6.2018	
Me objekt mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit “Sude në administrim”	3



VENDIM

Nr. 4956, datë 1.6.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Antonela Prendi, gjyqtare,

asistuar nga sekretare gjyqësore Gencjana Dada, sot, në datën 1.6.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me nr. 160 akti, që i përket:

KËRKUES: Subjekti huamarrës “Sude në administrim”, përfaqësuar nga administratorja e falimentimit Mimoza Cibuku, licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 7, datë 15.10.2012, me adresë: sheshi “Karl Topia”, rruga “Kongresi i Përmetit”, pallati 127, kulla nr. 3.

OBJEKTI: Mbyllje e procedurës së falimentimit të subjektit “Sude në administrim”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008. Neni 163 i KC-së dhe Kodi i Procedurës Civile të RSH-së.

Gjykata, pasi administroi provat, deklaroi të mbyllur hetimin gjyqësor, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të administres së falimentimit Mimoza Cibuku; përfaqësuesit të subjektit “Sude në administrim”, Vladimir Meco; përfaqësuesve të komitetit të kreditorëve, të cilët kërkuan mbylljen e procedurës së falimentimit për shkak të likuidimit të pasurive të debitorit dhe shpërndarjes së të ardhurave kreditorëve të falimentimit,

VËREN:

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 22.8.1997, subjekti huamarrës “Sude” është shpallur subjekt kontrolli financiar dhe administrimi, referuar dispozitave të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, ndryshuar me ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997.

Ky subjekt rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë e huamarrjes publike, me qëllim rikthimin e vlerave monetare huamarrësve, përkundrejt interesave. Vënia e këtij subjekti nën administrimin dhe kontrollin shtetëror kishte për qëllim verifikimin paraprakisht të gjendjes financiare, administrimin e pasurisë dhe kthimin e vlerave monetare huamarrësve.

Pas një procesi të gjatë të administrimit shtetëror sipas akteve ligjore dhe nënligjore specifike, shteti shqiptar, përmes miratimit të ligjit nr. 41/2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, vendosi shpërndarjen e grupit mbikëqyrës të subjekteve të kontrollit dhe dorëzimin e gjithë dokumentacionit arkivor dhe asetëve financiare personit të ngarkuar nga Ministria e Financave. Njëkohësisht u vendos emërimi i një administratori për administrimin e mëtejshëm të subjekteve të kontrollit deri në likuidimin e plotë të tyre, duke akorduar dhe një buxhet limit për mbulimin e shpenzimeve të administrimit dhe të likuidimit.

Administratori i emëruar nga ministri i Financave detyrohej të evidentonte gjendjen reale të pasurive të shoqërisë dhe të paraqiste në gjykatë kërkesat për çeljen e procedurave të falimentimit, në rast se ekzistonin kushtet ligjore. Sa më sipër, sanksionohet në nenet 1, 3 dhe 4, të ligjit nr. 41/2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”:

Grupi mbikëqyrës i emëruar dhe që ka funksionuar në përputhje me ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, shpërndahet. (Neni 1)

Për administrimin e mëtejshëm të subjekteve të kontrollit deri në likuidimin e plotë të tyre, ministri i Financave emëron një administrator me një staf ndihmës, si dhe përcakton një limit buxhetor vjetor nga të ardhurat e subjektit të kontrollit, për mbulimin e shpenzimeve të administrimit/likuidimit. (Neni 3)

Administratori, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet:

a) T’i raportojë ministrit të Financave gjendjen reale të pasurive të shoqërisë, subjekte të kontrollit, nëpërmjet një raporti të hollësishëm, të shoqëruar me pasqyrat financiare të vitit më të fundit ushtrimor për secilën shoqëri administrimi;

b) Të depozitojë në gjykatë kërkesat për faliment të të gjitha shoqërive, subjekte të kontrollit të marra në administrim ...” (neni 4).

Referuar kuadrit të mësipërm ligjor, administratori i subjekti huamarrës “Sude në administrim” (z. Zini Tollozhina) paraqiti pranë



Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën për çeljen e procedurës së falimentimit për këtë subjekt kontrolli.

Paraprakisht, gjykata, duke marrë në konsideratë kërkesat procedurale të nenit 16 të KPRC-së, i cili sanksionon: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj”, arriti në konkluzionin se:

Kuadri i posaçëm ligjor që ka sanksionuar fillimin e procedurave të falimentimit të subjekteve huamarrëse, përmes paraqitjes së kërkesave në gjykatë, nuk ka përcaktuar procedura të veçanta për këtë proces, çka orienton vendimmarrjen gjyqësore në zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008.

Pasi administroi provat e paraqitura në gjykim nga administratori i subjektit “Sude në administrim”, në raport me pasuritë dhe detyrimet e këtij subjekti kundrejt të tretëve (kreditorëve), gjykata mori në shqyrtim dispozitat e mëposhtme të ligjit “Për falimentimin”:

Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon:

1. Procedura e falimentimit **hapet vetëm me shkak**.

2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

4. **Mbingarkesa me borxhe** përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë ...

Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), sanksionon:

1. Procedura e falimentimit hapet vetëm **me kërkesën e debitorit** ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare.

Neni 15 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon:

Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj, duhet të paraqesin:

a) Listën e pasurive dhe të të ardhurave së bashku me një deklaratë ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur ose është ngarkuar me barrë si i tillë;

b) Listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

2. Dokumentacioni duhet të përmbajë dhe një deklaratë përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), sanksionon:

Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos:

c) Pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit.

Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon:

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit, kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit.

2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban:

a) Emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë;

b) Emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit;

c) Orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit;

c) Të dhënat e parashikuara në nenet 27 dhe 29 të këtij ligji;

d) Urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës.

4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të përkohshëm të falimentimit.

Në analizë të kushteve ligjore që determinojnë çeljen e procedurës së falimentimit, gjykata vlerësoi si më poshtë vijon:

Procedura e falimentimit në thelb përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo të mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka



për qëllim likuidimin e subjektit nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt në rast se konkludohet se një veprim i tillë është i mundur.

Fillimi në rrugë gjyqësore i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit, i konceptuar si:

- a) Gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim; ose
- b) Mbingarkesës së subjektit me borxhe.

Legjitimimin aktiv për iniciimin e procedurave gjyqësore të falimentimit e gëzon kreditori, **debitori**, sikurse rezulton në rastin objekt gjykimi, si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale trevjeçare.

Me qëllim hetimin e ekzistencës së shkakut të falimentimit, gjykata caktoi në cilësinë e administratores së përkohshme të falimentimit znj. Mimoza Cibuku, e cila, pasi analizoi provat e administruara në gjykim, konkludoi:

1. Subjekti “Sude në administrim” rezulton i mbingarkuar me borxhe, gjendje financiare e cila përbën shkak ligjor për çeljen e procedurës së falimentimit.

Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur provohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet e maturuara ndaj të tretëve dhe pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk ekziston mundësia e vazhdimësisë së veprimtarisë së tij.

Subjekti “Sude në administrim” nuk është shoqëri e formësuar sipas legjislacionit tregtar shqiptar. Për këtë arsye, nuk kemi të bëjmë me falimentimin e një shoqërie të rregullt, por të një subjekti huamarrës, administrimi i të cilit ka qenë i rregulluar me ligj të veçantë.

Pasuritë e subjektit “Sude në administrim” nuk mjaftojnë për të paguar detyrimet ndaj kreditorëve, të cilat janë maturuar prej shumë vitesh.

Pasuria e subjektit përmbledhet në vlera monetare në shumën **5 531 606 lekë**, të depozituara pranë Bankës Credins, e konfirmuar nga ekstrakti i bankës dhe vetë administratori i subjektit huamarrës.

Detyrimet e subjektit ndaj të tretëve rezultojnë në vlerën **39 232 710 lekë**, referuar numrit të kreditorëve dhe vlerave të tyre të detyrimit.

Për sa u takon kreditorëve në listat

bashkëngjitur raportit të vlerësimit, paraqiten si më poshtë vijon:

A. Listat e kreditorëve, të sekuestruara nga organi i akuzës pranë subjektit huamarrës:

1. Listë kreditorësh për arkëtimet sipas datave të arkëtimit, gjithsej 3368 kreditorë, në shumën totale të detyrimit 13,327,250,000 lekë;

2. Listë kreditorësh me numër mandatesh arkëtimi, gjithsej 129 kreditorë, në shumën totale të detyrimit 848,300,000 lekë;

3. Listë kreditorësh të regjistruar nga organi i akuzës, gjithsej 2197 kreditorë, në shumën totale të detyrimit 7,654,550,000 lekë.

B. Listat e kreditorëve, sipas deklarimeve të bëra prej tyre pranë organit të akuzës, në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale (të dëmtuar nga vepra penale), gjithsej 2079 kreditorë, në shumën totale të detyrimit 17,399,610,000 lekë.

Vlera totale e detyrimit të subjektit huamarrës kundrejt kreditorëve të tij është **39,232,710,000 lekë**.

Sa më sipër, u konkludua se kreditorët e subjektit “Sude në administrim” ndodhen në pamundësi për të arkëtuar vlerat e plota të kredisë së tyre, pasi raporti i aktiveve me detyrimin deri në datën 9.9.2013 është 1:709.25, pra kreditorët për 709.25 lekë të depozituara përfitojnë 1 lek.

2. Pasuritë e subjektit “Sude në administrim” mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Duke përllogaritur shpenzimet e procedurës së falimentimit, ku përfshihet edhe pagesa e administratores së falimentimit dhe faktin se për secilin subjekt huamarrës është miratuar një fond i veçantë për mbulimin e shpenzimeve të administrimit dhe të likuidimit total të tyre, administratorja e përkohshme e falimentimit konkludoi se pasuria e subjektit huamarrës mbulon shpenzimet e procedurës së falimentimit. Nuk u çmua e nevojshme marrja e masave për sigurimin e pasurisë, në kushtet kur pasuria e vetme e këtij subjekti huamarrës ishin vlerat monetare të depozituara pranë Bankës Credins.

Pasi konfirmoi ekzistencën e shkaqeve ligjore për çeljen e procedurës së falimentimit, gjykata, me vendimin nr. 12656, datë 18.12.2013, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën 12:30 min., të datës 18.12.2013, të procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim”, me administrator z. Zihni Tollozhina, i emëruar me



urdhërin nr. 3386, datë 28.2.2013, të ministrit të Financave, me adresë: Rruga e Kavajës, ish-Mjetet Mësimore, Tiranë.

2. Emërimin si administratore të falimentimit për subjektin huamarrës “Sude në administrim”, znj. Mimoza Cibuku, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 7, datë 15.10.2012, me adresë: sheshi “Karl Topia”, rruga “Kongresi i Përmetit”, pallati 127, kulla 3.

3. Të gjithë kreditorët e subjektit huamarrës “Sude në administrim” të paraqesin pranë administratores së falimentimit pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

4. Të gjithë kreditorët e subjektit huamarrës “Sude në administrim” të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

5. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, subjekti huamarrës “Sude në administrim” t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit.

6. Mbledhja e kreditorëve të subjektit huamarrës “Sude në administrim”, për raportim të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

7. Mbledhja e kreditorëve të subjektit huamarrës “Sude në administrim” për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

8. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” në Buletinin e Njoftimeve Publike.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’i dërgohet Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha ZVRPP-ve vendore dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të RSH-së.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

14. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim”, në dy gazeta me qarkullim kombëtar.

16. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

17. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes. Për personat e tretë, në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Ndaj vendimit për çeljen e procedurave të falimentimit, i cili është menjëherë i ekzekutueshëm, nuk është ushtruar ankim.

Gjykata respektoi urdhërimet ligjore për publikimin e vendimit për çeljen e procedurës së falimentimit në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këndin e njoftimeve zyrtare të gjykatës, në dy gazeta me qarkullim kombëtar, pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë në RSH, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Në vijimësi, administratorja e falimentimit procedoi me sigurimin e të dhënave në raport me pasuritë e subjektit në falimentim, pranë:

- Zyrrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në RSH, të cilat konfirmuan shkresërisht, se për subjektin “Sude”, në falimentim, nuk figurojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme;

- Bankave të nivelit të dytë në RSH, të cilat konfirmuan se subjekti në falimentim nuk ka depozita dhe llogari bankare.



- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, e cila përmes shkresës nr. 3703/1 prot., datë 15.4.2014, informoi se nuk rezultojnë të regjistruara automjete në pronësi të subjektit “Sude”.

Administratori e falimentimit, Mimoza Cibuku, kërkoi zhvillimin e mbledhjes për raportim të kreditorëve, që sipas urdhërimeve të gjykatës në vendimin për hapjen e procedurës për falimentim, duhet të mbahej brenda 90 ditëve nga shpallja e vendimit referuar parashikimeve të nenit 28/1/a, të ligjit “Për falimentimin”:

1. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton afatet kohore për: a) Zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për raportim. Kjo mbledhje duhet të mbahet brenda 45 ditëve dhe jo më vonë se 90 ditë nga data e shpalljes së vendimit, në bazë të një raporti të administratorit të falimentimit, duhet të vendosë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së falimentimit.

Nga ana e administratores së falimentimit u depozituan në gjykatë listat e kreditorëve, të evidentuar si të tillë nga dokumentacioni i administruar nga vetë subjekti “Sude” dhe kreditorët që paraqitën pretendimet e tyre pranë administratores, brenda afatit 90-ditor pas çeljes së procedurës së falimentimit:

Neni 27/1 i ligjit “Për falimentimin”:

Në vendimin për hapjen e procedurës së falimentimit kreditorëve u kërkohet të paraqesin brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar në të, të administratori i falimentimit, pretendimet e tyre, sipas nenit 144 të këtij ligji. Afati kohor për paraqitjen e pretendimeve nuk mund të jetë më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë.

Në listat e kreditorëve evidentohet identiteti i tyre, shuma e pretenduar e kredisë kundrejt subjektit në falimentim dhe burimi i tyre. Kreditorët janë persona fizikë huadhënës të cilët dispononin mandate ku evidentoheshin shumat e dhëna hua:

Nenet 120, 122, të ligjit “Për falimentimin”:

1. Administratori i falimentimit barton listën e të gjithë kreditorëve të debitorit, të cilët janë bërë të njohur nga librat e dokumentet e punës së debitorit, nëpërmjet njoftimit të debitorit, me kërkesë të tyre ose me ndonjë mënyrë tjetër.

Lista me sendet e masës së falimentit, lista e kreditorëve dhe tabela e pasurisë, depozitohen në regjistrin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për t’u inspektuar

nga palët, jo më vonë se një javë para mbledhjes për raportim.

Mbledhja për raportim u mbajt në datën 18.3.2014 dhe për zhvillimin e saj u realizuan njoftime përmes shpalljes publike, për shkak të numrit të lartë të kreditorëve (shpallje pranë adresës së administratores së falimentimit, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në gazetatat me qarkullim kombëtar *Shqip* dhe *Panorama*).

Në mbledhjen për raportim morën pjesë 16 kreditorë dhe administratorja e falimentimit Mimoza Cibuku. Pjesëmarrja, raportimi i administratores dhe vendimarrjet pasqyrohen në procesverbalin, datë 18.3.2014, të administruar në dosjen gjyqësore.

Nga ana e administratores së falimentimit u paraqit një raport ku evidentohet gjendja ekonomike e subjektit “Sude”, në falimentim, shkaqet e falimentimit dhe mënyrën e realizimit të tij, përmes likuidimit, duke respektuar kërkesat e nenit 124, të ligjit “Për falimentimin”:

1. Në mbledhjen e raportimit, administratori i falimentimit raporton mbi gjendjen ekonomike të debitorit dhe shkaqet e falimentimit. Ai analizon çdo perspektivë të veprimtarisë së debitorit, tërësisht ose pjesërisht, tregon mundësinë e ekzistencës së një plani riorganizimi dhe përsbkruan pasojat e secilës prej zgjidhjeve për ripagimin e kreditorëve.

Në raportin e paraqitur gjatë mbledhjes për raportim, administratorja e falimentimit përgatiti bilancin kontabël të gjendjes së subjektit në çastin e çeljes së procedurës së falimentimit, inventarin kontabël të të drejtave dhe detyrimeve, analizën e marrëdhënieve me të tretët.

Në raport parashtrohet se subjekti në falimentim nuk ka kryer aktivitet gjatë 5 viteve të fundit përpara çeljes së falimentimit, por ka qenë në administrim nga grupi mbikëqyrës dhe më pas nga administratori i caktuar nga ministri i Financave. Duke marrë në konsideratë që aktiviteti i ushtruar nga subjekti në falimentim ka qenë i kundërligjshëm, riorganizimi i tij, si një ndër alternativat ligjorë rezultoi i pamundur, fakt që orienton procesin e falimentimit në formën e likuidimit (si administratore e falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” rekomandoj që vazhdimi i procedurës së falimentimit të kryhet përmes likuidimit). Ky konkluzion i administratores së



falimentimit u gjet i drejtë nga kreditorët pjesëmarrës në mbledhje.

Gjatë mbledhjes për raportim u procedua me zgjedhjen e komitetit të kreditorëve konform nenit 54, të ligjit “Për falimentimin”:

1. *Para mbledhjes së parë të kreditorëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka të drejtë të caktojë një komitet të kreditorëve.*

2. *Komiteti i kreditorëve duhet të përfaqësojë kreditorët e siguruar, kreditorët e falimentimit me pretendimet më të mëdha dhe kreditorët e shumave të vogla.*

Kreditorët pjesëmarrës në mbledhje zgjodhën me unanimitet komitetin e kreditorëve të përbërë nga Stefan Kocaj, Simon Kuraj dhe Marika Simaku, në respektim të nenit 63/2, të ligjit “Për falimentimin”:

Vendimet e mbledhjes së kreditorëve janë të vlefshme nëse shumica e pretendimeve të kreditorëve në favor të vendimit është më e madhe se gjysma e shumës së përgjithshme të pretendimeve të kreditorëve me të drejtë vote ...

Komiteti i kreditorëve ka mbikëqyrur veprimtarinë e administratores së falimentimit dhe ka marrë pjesë në vendimmarrjet gjatë ecurisë së procesit (neni 56: *Anëtarët e komitetit të kreditorëve duhet të mbështesin dhe të mbikëqyrin veprimtarinë e administratorit të falimentimit. Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për ecurinë e punëve gjatë procesit të falimentimit, të kontrollojnë librat e llogarive dhe dokumente të tjera dhe të verifikojnë veprimet monetare dhe gjendjen e arkës*).

Në datën 23.5.2014, administratorja e falimentimit paraqiti në gjykatë tabelat e pretendimeve të kreditorëve, të cilët kanë paraqitur pretendimet e tyre me shkrim, kundrejt subjektit debitor në falimentim, të bashkëshoqëruara me dokumentacionin e paraqitur nga secili prej tyre:

1. Tabelat e pretendimeve të kreditorëve, datë 7.4.2014, të paraqitura brenda afatit ligjor, gjithsej 25 kreditorë.

2. Tabelat e pretendimeve të kreditorëve, të paraqitura jashtë afatit ligjor:

- tabela, datë 19.5.2014, gjithsej 142 kreditorë;
- tabela, datë 26.5.2014, gjithsej 132 kreditorë;
- tabela, datë 27.5.2014, gjithsej 139 kreditorë;
- tabela, datë 30.5.2014, gjithsej 133 kreditorë;
- tabela, datë 3.6.2014, gjithsej 123 kreditorë;

- tabela, datë 4.6.2014, gjithsej 134 kreditorë;

- tabela, datë 5.6.2014, gjithsej 133 kreditorë;

- tabela, datë 6.6.2014, gjithsej 116 kreditorë;

- tabela, datë 17.6.2014, gjithsej 115 kreditorë.

Sa më sipër, parashikohet në nenin 142, të ligjit “Për falimentimin”, i cili sanksionon:

Administratori i falimentimit regjistron të gjitha pretendimet me të dhënat, sipas pikës 2, të nenit 141, të këtij ligji. Tabela e pretendimeve depozitohet në zyrën e gjykatës bashkë me aplikimet dhe vërtetimet e bashkëlidhura për inspektimin e bërë nga palë, brenda një periudhe kohore sa një e treta e kohës ndërmjet ditës së fundit të afatit të depozitimit dhe të mbledhjes për verifikimin e pretendimeve.

Pas depozitimit të tabelave të pretendimeve, procedura e falimentimit vijoi me thirrjen e mbledhjes për verifikim, e cila u realizua pas 60 ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së pretendimeve të kreditorëve, sikurse gjykata kishte urdhëruar në vendimin për çeljen e procedurës së falimentimit. Për shkak të numrit të lartë të kreditorëve të falimentimit u zhvilluan disa mbledhje për verifikim, të evidentuara në procesverbalet respektive:

1. Në mbledhjen e datës 19.5.2014 u verifikuan pretendimet e 93 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

2. Në mbledhjen e datës 26.5.2014 u verifikuan pretendimet e 88 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

3. Në mbledhjen e datës 27.5.2014 u verifikuan pretendimet e 80 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

4. Në mbledhjen e datës 30.5.2014 u verifikuan pretendimet e 89 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

5. Në mbledhjen e datës 3.6.2014 u verifikuan pretendimet e 114 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

6. Në mbledhjen e datës 4.6.2014 u verifikuan pretendimet e 88 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

7. Në mbledhjen e datës 5.6.2014 u verifikuan pretendimet e 127 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

8. Në mbledhjen e datës 6.6.2014 u verifikuan pretendimet e 91 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje;

9. Në mbledhjen e datës 17.6.2014 u verifikuan pretendimet e 81 kreditorëve të pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje.



Për mbledhjet e sipërreferuara, subjektet kreditore u njoftuan përmes shpalljes publike, diktuar nga numri i lartë i tyre (*shpallje në këndin e njoftimeve të gjykatës, në faqen zyrtare të internetit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, në Buletinën e Njoftimeve Publike pranë Autoritetit Rrugor Kombëtar, në adresën e administratorës së falimentimit, në adresën e administratorit të subjektit huamarrës*) konform nenit 9, të ligjit “Për falimentimin”:

1. *Shpalljet publike të vendimeve dhe të akteve për fillimin dhe përfundimin e procedurës së falimentimit, bëhen me publikimin e tyre në organet e informacionit të caktuar për njoftimet zyrtare të gjykatës.*

5. *Shpalljet publike sipër dispozitave të këtij ligji merren si njoftim i të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e falimentimit edhe sikur dispozita të veçanta të këtij ligji të kërkojnë njoftim të veçantë.*

Mbledhjet për verifikimin e pretendimeve u zhvilluan me pjesëmarrjen e kreditorëve, komitetit të kreditorëve dhe përfaqësuesit të debitorit në falimentim.

Gjatë mbledhjes për verifikim u shqyrtuan të gjitha pretendimet e kreditorëve pjesëmarrës, sipas shumave respektive dhe u morën njëkohësisht në shqyrtim dhe depozitimet e vonuara, e drejtë që buron nga dispozitat e ligjit “Për falimentimin”:

Neni 143: Në mbledhjen e verifikimit shqyrtohen pretendimet e paraqitura për shumën dhe statusin e tyre ...

Neni 144: Gjatë mbledhjes së verifikimit shqyrtohen dhe pretendimet e paraqitura pas përfundimit të afatit të depozitimit ...

Gjatë mbledhjes për verifikim u administrua dokumentacioni i kreditorëve, që gëzonin cilësinë e huadhënësit ndaj subjektit në falimentim, i cili përbëhesh nga mandate të lëshuara nga debitori “Sude në administrim”, ku evidentohet emri i kreditorit dhe shuma e dhënë hua.

Pretendimet e paraqitura gjatë mbledhjes për verifikim nuk u kundërshtuan nga debitori dhe kreditorët, por për disa prej tyre parashtrori kundërshtimet e veta administratorja e falimentimit, të cilat pasqyrohen në proces-verbalet e mbledhjeve respektive, shoqëruar me argumentin përkatës, e drejtë që bazohet në nenin 143, të ligjit “Për falimentimin”:

... Pretendimet që kundërshtohen nga administratori i falimentimit, debitori ose një kreditor falimentimi, i nënshtrohen një diskutimi të hollësishtëm dhe të veçantë.

Pretendimet e kreditorëve, të cilat nuk u kundërshtuan gjatë mbledhjes për verifikim, konsiderohen të vërtetuara në kuptim të nenit 145, të ligjit “Për falimentimin”, ndërsa për kreditorët ndaj të cilëve pati kundërshtime administratorja e falimentimit përgatiti tabelën e kreditorëve të kundërshtuar, ku pasqyrohen arsyet dhe shuma e kundërshtuar, konform nenit 145, të ligjit “Për falimentimin”:

1. *Një pretendim vlerësohet i vërtetuar, nëse në mbledhjen e verifikimit ose gjatë procedurës me shkrim, nuk është kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose kreditorët e falimentimit, sipas nenit 144 të këtij ligji ose kur është hedhur poshtë ndonjë kundërshtim i paraqitur. Kundërshtimi i debitorit nuk pengon vërtetimin e pretendimit.*

2. *Për çdo pretendim të depozituar, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit shënon në tabelë se në çfarë mase është vërtetuar shuma dhe statusi ose cila prej palëve ka kundërshtuar vërtetimin. Në tabelë regjistrohen dhe kundërshtimet e debitorit ...*

3. *Në pretendimet e vërtetuara për shumën ose statusin e tyre, regjistrimi në tabelë ka pasojën juridike të një vendimi të formës së prerë për administratorin e falimentimit dhe për të gjithë kreditorët e falimentimit.*

Tabela e pretendimeve të kundërshtuara u depozitua në kryesekretarinë gjyqësore dhe u realizua publikimi i saj në një gazetë me qarkullim kombëtar, në këndin e njoftimeve të gjykatës dhe në faqen e saj zyrtare të internetit. Kreditorëve të përfshirë në këto tabela iu mundësua e drejta e vërtetimit të pretendimit të kundërshtuar përmes padisë civile dhe, për pasojë, korrigjimit të tabelës së pretendimeve, duke u përfshirë në listën e kreditorëve me pretendime të vërtetuara, konform neneve 147 dhe 148, të ligjit “Për falimentimin”:

1. *Padia për vërtetimin e pretendimeve ngrihet sipas dispozitave të procedurës së zakonshme civile.*

1. *Vendimi i formës së prerë që vërteton një pretendim ose që pranon një kundërshtim është detyrues për administratorin e falimentimit dhe për të gjithë kreditorët e falimentimit.*

Kreditori i kundërshtuar, Gazmend Guma, vërtetoi pretendimin e tij gjyqësisht, sipas dispozitave të sipërreferuara të ligjit “Për falimentimin”, përmes vendimit nr. 10980, datë



14.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, duke u përfshirë në listën e kreditorëve të subjektit huamarrës në falimentim “Sude”.

Në kushtet kur masa e falimentit të subjektit huamarrës “Sude” përbëhej vetëm nga vlera monetare (likuiditete) në shumën 5 139 774 lekë, të depozituara pranë “Bankës Credins” sh.a., administratorja e falimentimit, në datën 2.9.2014, vendosi shpërndarjen e masës së falimentit, vendim i aprovuar unanimisht dhe nga komiteti i kreditorëve, konform nenit 150, të ligjit “Për falimentimin:

1. Ripagimi i kreditorëve të falimentimit mund të fillojë vetëm pas mbledhjes së verifikimit të përgjithshëm.

2. Fondet mund t’u shpërndahen kreditorëve të falimentimit sapo masa e falimentimit të ketë likuidite të mjaftueshme ...

3. Shpërndarja bëhet nga administratori i falimentimit sipas renditjes së parashikuar në nenin 605 të KC-së. Para çdo shpërndarjeje, ai duhet të marrë miratimin e komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar një i tillë.

Administratorja ka miratuar shpërndarjen e masës së falimentimit prej **5 139 774 lekësh** mes **1170 kreditorëve**. Në përmbajtje të vendimit parashtrohet se shuma e verifikuar e pretendimeve është 1 269 080 lekë, shuma për t’u shpërndarë 5 139 774 lekë dhe koeficienti 0,405%. Sa më sipër, në tabelën mbi shpërndarjen e masës së falimentimit, evidentohet për secilin kreditor vlera takuese, duke përlllogaritur koeficientin në raport me shumën e vërtetuar të kredisë për secilin prej tyre.

Duhet nënvizuar, se nuk ka kreditorë të preferuar në këtë procedurë falimentimi, në kuptim të nenit 605 të KC-së, pasi kreditë e tyre kanë të njëjtin status ligjor (marrëdhënie huaje).

Për shpërndarjen e masës së falimentimit u realizuan shpallje publike, përfshi njoftimet në shtyp. Njëkohësisht, administratorja e falimentimit ka informuar në mënyrë të vazhdueshme gjykatën në raport me shumën e tërhequra në kohë të ndryshme nga kreditorët, referuar informacioneve shkresore të administruara në dosjen gjyqësore.

Me vendimin nr. 1100 akti, datë 15.4.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë miratoi shpërblimin për administratoren e falimentimit Mimoza Cibuku, në masën 605 923 lekë dhe

rimbursimin e shpenzimeve të kryera për procedurën e falimentimit, në shumën 131 110 lekë, në bazë të neneve 50, 51 dhe 52, të ligjit “Për falimentimin” dhe VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe shpenzimet e administratorit të falimentimit”:

1. Administratori i falimentimit ka të drejtën e shpërblimit për punën e kryer dhe rimbursimin e shpenzimeve të bëra gjatë përmbushjes së detyrës.

2. Masa e zaksnshme e shpërblimit vendoset në bazë të vlerës së masës së falimentimit, në kohën e përfundimit të procedurës së falimentimit.

3. Masa e zaksnshme e shpërblimit vlerësohet në varësi të vëllimit dhe shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorit të falimentimit. (Neni 50)

Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton me vendim shpërblimin dhe shpenzimet që duhet t’i rimbursohen administratorit të falimentimit.

Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, me përjashtim të shumës së parashikuar, duhet të shpallet publikisht dhe t’i njoftohet personalisht administratorit të falimentimit, debitorit, anëtarëve të komitetit të kreditorëve, nëse është emëruar prej tyre. Në vendimin e seksionit tregtar të rrethit, të shpallur publikisht, duhet të vihet në dukje se teksti i plotë i vendimit gjendet në sekretarinë e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ... (Neni 51)

Shpërblimi i administatores së falimentit është llogaritur në vlerën 8% të masës së falimentimit (5 858 702 lekë) dhe një shpërblim shtesë prej 0.05% mbi pasivin e falimentit, sipas VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007. Ndërsa, shpenzimet e masës së falimentimit, sipas zërave respektivë të pasqyruar në vendimin nr. 1100 akti, datë 15.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërtetohen nga faturat tatimore të administruara në dosjen gjyqësore.

Nga informacioni i paraqitur gjykatës nga administratorja e falimentimit Mimoza Cibuku, rezulton se prej datës 2.9.2014, kur u miratua shpërndarja e masës së falimentimit, 1170 kreditorëve dhe deri në datën 24.11.2017, kanë tërhequr vlerat takuese monetare 660 kreditorë, në shumën 3 351 787 lekë dhe kanë mbetur pa tërhequr 534 kreditorë, në vlerën 1 796 518.89 lekë. Sa më sipër parashtrohet në raportin e datës 24.11.2017 të administatores së falimentimit, të cilit i bashkëlidhen informacionet e përcjella nga



“Banka Credins” sh.a. Administratorja e falimentimit i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për hapjen e një llogarie bankare për depozitimin e shumave të patërhequra nga kreditorët. Me shkresën nr. 13076/1 prot., datë 17.10.2017, është miratuar hapja e llogarisë në lekë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 217 akti, datë 22.12.2017, vendosi të pranojë kërkesën e administratores së falimentimit Mimoza Cibuku dhe të urdhërojë depozitimin pranë “Bankës Credins” sh.a., në nr. e llogarisë: 00000980764, të çelur në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të shumës së patërhequr nga kreditorët e subjektit në falimentim “Sude”, në shumën 1 796 518.89 lekë, në bazë të nenit 161, të ligjit “Për falimentimin”:

Shumat që janë mbajtur gjatë shpërndarjes përfundimtare depozitohen në një agjenci të përshtatshme, me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, për llogari të palëve pjesëmarrëse.

Me shpërndarjen e masës së falimentimit dhe depozitimin e shumave të patërhequra në “Bankën Credins” sh.a., administratorja e falimentimit kërkoi thirrjen e mbledhjes përfundimtare të kreditorëve, e cila u mbajt në datën 1.6.2018, pas njoftimit përmes shpalljes publike të pjesëmarrësve në këtë procedurë.

Mbledhja u zhvillua në prezencë të përfaqësuesit të debitorit, komitetit të kreditorëve dhe administratores së falimentimit, sikurse pasqyrohet në procesverbalin e administruar në dosjen gjyqësore.

Administratorja e falimentimit paraqiti një raport përfundimtar në lidhje me llogaritë e procedurës së falimentimit, ku përfshihet:

1. Llogaritë përfundimtare, të gjitha arkëtimet dhe pagesat e kryera nga administratori i falimentimit nga data e hapjes së procedurës së falimentimit.

Masa e falimentimit përbëhej vetëm nga likuiditete të depozituara në Bankën Credins, në shumën 5 814 322.46 lekë.

2. Aktivitetet e zbuluara gjatë procedurës së falimentimit. Sipas informacioneve të marra nga administratorja e falimentimit, subjekti “Sude”, nuk ka pasur pasuri të regjistruara në pronësi të tij.

3. Detaje të aktivitetit gjyqësor dhe financiar të procedurës së falimentimit.

U paraqit njëkohësisht dhe mandati që vërteton depozitimin në bankë të shumave të patërhequra nga kreditorët.

Bashkëngjitur raportit paraqitet aneksi nr. 1, ku evidentohet llogaria përfundimtare në lidhje me procedurën e falimentimit të subjektit huamarrës “Sude”.

Nga pjesëmarrësit nuk u paraqitën kontestime në lidhje me raportin e administratores së falimentimit.

Diskutimi i llogarive përfundimtare të procedurës së falimentimit në mbledhjen përfundimtare të kreditorëve bazohet në nenin 160, të ligjit “Për falimentimin”:

1. Kur jepet pëlqimi për shpërndarjen përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përvakton afatin për një mbledhje përfundimtare të kreditorëve. Gjatë mbledhjes:

a) Diskutohen llogaritë e paraqitura nga administratori i falimentimit;

b) Vërejtje ndaj listës përfundimtare;

c) Vendosi për sendet që janë pjesë e masës së falimentit dhe të papërshtatshme për shitje.

Shpërndarja e masës së falimentimit dhe mbajtja e mbledhjes përfundimtare të kreditorëve përbën momentin fundor juridik dhe financiar të procedurës së falimentimit, e cila pasohet nga vendimi gjyqësor për mbylljen e procedurës së falimentimit, konform nenit 163, të ligjit “Për falimentimin”:

Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit.

Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht.

Procesi i falimentimit i subjektit huamarrës “Sude” konkludoi në formën e likuidimit, ku e vetmja pasuri në trajtën e likuiditeteve u shpërnda mes kreditorëve, nga të cilët një pjesë e tyre paraqitën interes për tërheqjen e vlerave monetare takuese.

Në këtë mënyrë, i gjithë operacioni juridik dhe financiar i falimentimit, i realizuar në përputhje me dispozitat e ligjit “Për falimentimin”, nën drejtimin e administratorit të falimentimit dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës, me pjesëmarrjen në çdo fazë të procesit dhe vendimarrjeve të komitetit të kreditorëve dhe përfaqësuesit të debitorit, realizoi qëllimin final të sanksionuar në nenin 1 të ligjit, shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave kreditorëve.



Në kushtet kur debitori në falimentim nuk rezulton të ketë ushtruar aktivitetin, i organizuar në formën e tregtarit, person fizik apo shoqëri tregtare, disponimi përfundimtar gjyqësor, në lidhje me këtë gjykim, do të përqendrohet vetëm te mbyllja e procedurës së falimentimit, në ndryshim nga subjektet debitore që kanë formën e shoqërisë ku ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” imponon dhe urdhërimin gjyqësor për cregjistrimin e tij.

Në përfundim, gjykata vendosi mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim”.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të neneve 306 dhe 309 të KPRC-së dhe nenit 163, të ligjit “Për falimentimin”, gjykata

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim”.

2. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’i komunikohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” t’u komunikohet administratores së falimentimit Mimoza Cibuku dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

4. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

5. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Sude në administrim” në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentin.

7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot, në datën 1.6.2018, Tiranë.

SEKRETARE
Gencjana Dada

GJYQTARE
Antonela Prendi

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.